



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 03.04.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 30.03.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "DWH ALBANIA" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me instrument GPS", Nr. i prokurimit- 632-22-7865-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-073-121, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "DWH- ALBANIA" SH.P.K. e dt.30.03.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me instrument GPS", Nr. i prokurimit- 632-22-7865-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-073-121, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 27.03.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 27.03.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të anulohet aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.30.03.2023, Operatori Ekonomik "DWH ALBANIA" SH.P.K ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "Furnizim me instrument GPS", Nr. i prokurimit- 632-22-7865-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-073-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 03.04.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj i parë nuk qëndron , sepse Autoritetit kontraktues ka kërkuar qe kontratat për 3 vitet e fundit te dëshmojen se bashku me referencat për përmbylljen e suksesshme te kontratave, andaj ju nuk I keni ofruar këto ne dosjen e tenderit .

Pretendimi juaj i dytë gjithashtu nuk qëndron, sepse nuk i plotësoni specifikimet teknike te instrumenteve (GPS dhe Stacion Total), sipas kërkesës se autoritetit kontraktues (AK).

- Me konkretisht tek kontrollori I antenës se GNSS, Autoriteti kontraktues ka kërkuar një hapësire memorizuese jo me te vogël se 64GB, ndërsa ju keni ofruar një pajisje me hapësire memorizuese 4GB.
- Gjithashtu ne si AK, kemi kërkuar qe pajisja e ofruar (GPS) te mundësoj export/import të të dhënave gjeohapësinore ne formatet DWG, CSV, ShapeFile, TXT ndërsa ju si OE ne broshurat e ofruara keni prezantuar DWG/DXF(është kërkuar qe te vërtetohet përmes screenshot-ave ne softuer se cili format ekziston ndërmjet DWG/DXF). Gjithashtu mungojnë edhe formatet tjera të të dhënave si CSV, ShapeFile, TXT (Nëse këto formate ekzistojnë atëherë kemi kërkuar te argumentohen përmes screenshot-ave ne softuerin e instrumentit).

3. Konsiderojmë se edhe pretendimi juaj i tretë është i pabazuar, sepse Komisioni i vlerësimit, përbehet prej dy gjeodetëve që besojmë se është e mjaftueshme për vlerësimin e specifikimeve teknike te instrumenteve.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës